



Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Nr. 15

Datë: 18. 05. 2017, ora: 14:30

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Betim Gjoshi, Ilir Gashi, Sami Hamiti, Adnan Rustemi, Binak Vishaj, Eshref Vishi, Ercan Spat, Nenad Rikallo, Bajram Ljatifi, Ergit Qeli.

SKQZ: Enis Halimi, Kryeshef i SKQZ. Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPPC.

Miradije Meha, drejtoreshë e DAP-it. Përkthyes: Vera Dula.

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi (ZLKMP).

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;

- *Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes të KQZ-së nr.12/ 2017;*

2. Aktivitetet e Sekretariatit lidhur me procesin zgjedhor;

3. Raport i Këshillave të KQZ-së

- **Këshilli për Operacione Zgjedhore;**

- *Shqyrtimi dhe miratimi i specifikave të fletëvotimeve dhe broshurave për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës-2017;*

- **Këshilli për Çështje Ligjore**

- *Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal në Prizren ;*

4. Të ndryshme

1.Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes të KQZ-së nr.12/ 2017

Valdete Daka: E kemi mbledhjen e 15-të të radhës. A ka ndokush ndonjë propozim, ndonjë sugjerim për rendin e ditës...?

Bajram Ljatifi: Mendoj se sa i përketë votimit, duhet t'u mundësohet të gjithë atyre që janë në Listen Votuese që të votojnë. Edhe pse kjo nuk është si temë, le të futet në rend të ditës.

Valdete Daka: Po, mire. At'herë, kush është për këtë propozim të Bajramit dhe, ta votojmë rendin e ditës...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rendin e ditës. Në vazhdim, anëtarët e KQZ-së, miratuan procesverbalin e mbledhjes së KQZ-së, nr.12/ 2017

2.Aktivitetet e Sekretariatit lidhur me procesin zgjedhor

Enis Halimi: Sekretariati, ka vijue me angazhimin e vet për përmbushjen dhe me kryerjen e aktiviteteve dhe plotësimin e detyrave që ndërlidhen me procesin zgjedhor të qeshorit. Për sa i takon periudhës për aplikim për regjistrim që i kemi në raport, e që u kërkua dhe shpërndarjen sipas vendeve prej ku kan ardhë, përkatësisht, prej ku u shpreh interesim...Deri më tani, reth orës 13, e kemi bërë prerjen dhe i kemi pranuar 1716 aplikacione: 1347 jan aprovuar, 219 e kan statusin e pezulluar në mënyrë që kushtimit, as të pranuar dhe as të refuzuar por, në pritje për tu plotësuar dokumentacionit. Një aplikues, është refuzar. 188 aplikacione, jan të ashtquajtur pa status duke u rivlësuar ose duke u rivlersuar në të njejten kohë. Pjesën ma e madhe që thash edhe dje, e kemi pranuar përmes imellit. 18 aplikacione, i kemi pranuar përmes fax.

Aktivitetet tjera vijuese, tha z. Halimi, jan duke u zhvilluar në të gjitha barazhat. Është duke u punuar në dy ndërrime në mënyrë intesive që t'u japin shans të gjith të interesuarve që, brenda kapacitetit tonë mund t'i përthekojmë. Po ashtu, jemi pra mire..., punohet në dy ndërrime, i kemi edhe tabelat e aktiviteteve vijuse në brazhet e tjera duke vazhduar sipas dinamikës dhe planeve operacionale, dhe planeve tona që i kemi të brendshme të cilat, i kemi formatuar në atë kohë, në atë mënyrë që të mbërrijmë me kohë të gjitha aktivitetet deri më datën 11 qershor...

Valdete Daka: Faleminderit. A ka dikush tjetër...? Urdhëro...!

Nenad Rikallo: Sa përketë votimit jashë Kosovës, 22 maji është dita e fundit për pranim të materialit. Më interson një shpjegim i shkurtër: a është dat e fundit me mbërriri materiali, apo duhet të jenë të vulosur materialet në 22 përmes postës, sepse nëse ka vonesa...mund të kemi vonesa, dua të shpjegojem...sepse...!

Enis Halimi: Planin operacional kur e kemi hartuar, më 22 është data e fundit kur ato duhet të arrijnë këtu...sepse, nëse vijnë pas kësaj date, mund të kemi ngatërrimi...E kemi planifikuar, për shkak të procedurave të fazave të tjera, ato duhet të mbërrin ë më 22 maj...

Adnan Rrustemi: Po, kan mbetur deri më 22, edhe katër pesë ditë dhe shpresojmë që Sekretariati do të shpërndajë informacion sa më tepër që është e mundur, ti shfrytëzojm votuesit jashtë vendit me munësin e tyre dhe të drejtën e tyre për t'u regjistru dhe për të votuar. Natyrisht, u shqyrtua kjo çështje por, mua po më intereson një pyetje: A ka realizuar Sekretariati, respektivisht KQZ-ja ndonjë aktivitet të informimit publik për këtë periudhë, qoftë edhe ndonjë aktivitet alternative, e që, unë sa kam parë për shembull, informim përmes televizionit publik etj.

Enis Halimi: Po, në televizion publik po shkon materiali me titra që përfshinë edhe informatat që kanë të bëjnë me këto informacione njoftuese...Aty ku mundësitë i kemi ne po angazhohemi, deri sa ta përzgjedhim operatorin, deri sa të filloj çështja e emitimit të spoteve...

Adnan Rrustemi: Përndryshe, u bë e qartë se data 22, duhet me qenë afati i fundit kur aplikacionet pranohen nga KQZ-ja, megjithatë, e dimë që aktiviteti i cili pason, është periudha e sfidimit të listës së votuesve...

Betim Gjoshi : Për mua si process, është duke shkuar në rregull, d.mth., votimi jashtë vendit. Ka një interesim goxha të madhë dhe i përgezoj për këtë, dhe unë pajtohem me ato qe i ngritën kolegët... Janë të ndërlidhura çështjet por, edhe është afat shumë i shpejtë. Mendoj se, edhe pergjegja e kryeshefit ishte e saktë. Ne, kemi shtete që posta merr edhe 4-5 ditë për me ardhë, kështu që në qoftë se do të rrezikoheshin afatet e tjera, për mua është ok..., që ora 12 e natës e datës 22, të jetë afati i fundit. Përgjegjia e kryeshefit, është në ananalogji edhe me ligjin, se ligji thotë për pranim e flet votimit, kujtoj 24 orë para se me u mbyllë fletëvotimet, duhet me u dorëzu këtu te na, jo m`u nisë. Duhet me mbërri...

3. Raport i Këshillave të KQZ-së

- **Këshilli për Operacione Zgjedhore;**

Shqyrtimi dhe miratimi i specifikave të fletëvotimeve dhe broshurave për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës-2017

Adnan Rrustemi: Këshilli për Operacione Zgjedhore në mbledhjen e fundit, ka shqyrtuar specifikat teknike për shtypjen dhe paketimin e fletëvotimeve, dhe të broshurave, respektivisht të listave të kandidatëve për deputet për zgjedhjet e parakohëshme për Kuvendin e Republikës. Dokumenti përfshinë të gjitha aktivitetet dhe specifikat teknike të përmbajtjes së fletëvotimeve, të sasisë së tyre, të mënyrës së shpërndarjes, te elementeve të sigurisë që është më e rëndësishmja për fletëvotimet, por edhe specifikat teknike për listat e kandidatëve që shërbejnë në ditën e zgjedhjeve për informim të votuesve. Unë, detajet, dmth, i përfshijnë këtë informacion. Nuk është që ka ndryshuar nga praktika e mëparshme. Sa për informim, po e theksoj që, fletëvotimi përmban disa elemente të sigurisë, nga mikroprinti i vendosur diku brenda kuadratis të fletëvotimit, simboli që detektohet me llambë

ultravjollce, shiriti për pengimin e kopjimit, në kuptimin mrapa, dhe një fije siç n`a është thënë nga sekretariati të hologramit brenda. Ka edhe një element veçues në pjesën e mrapme, që është stema e republikës. Janë edhe drafti ose dizajni i listës së kandidatëve. Ne, e rekomandojmë KQZ-në që t`i miratoj dhe t`i hapë rrugë dhe t`i hapë rrugë procedurave për t`a realizuar këtë aktivitet të rendësishëm. Ajo çka mund të them, është që sasia që do të përcaktohet dhe do të vlerësohet në bazë të formules që tash po praktikon KQZ, sidomos në dy palë zgjedhje të fundit që mos me pasë sasi të teprueme të fletëvotimeve, por me bë një përlllogaritje mesatare që, në fakt, një numer më pak të fletëvotimeve se sa numri i votuesve, por gjithmonë duke siguruar që ka numer të mjaftueshem të fletëvotimeve. Ju faleminderit!

Valdete Daka: A ka dikush pyetje?

Ercan Spat: Unë, nuk kam pyetje por, vlerësoj se duhet përmendur stema e Republikës Kosovës e cila është në faqen e mrame, është risi më duket, dhe mendoj se është edhe një element shtesë sigurie.

Valdete Daka: Pra, siguria e fletëvotimeve është në nivelin ma të naltë të mundshëm...dhe mendoj se kjo është edhe një ëprgjegjësi përballë votuesve se, procesi do të jetë në nivel të lartë sigurie. Pra, kush është për këtë dizajn...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan specifikat e fletëvotimeve dhe broshurave për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës-2017

4.Këshilli për Çështje Ligjore

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal në Prizren

Sami Hamiti: Në mbledhjen e dhjetë për çashtje ligjore, kemi shqyrtuar dhe miratuar kërkesën për zëvendësimin e antarit të Kuvendit Komunal në Prizren, dhe unanimisht kemi votu që si pikë e rendit të ditës zëvendësimin në KQZ plotësohen gjitha kushtet ligjore për zëvendësimin e tij.

Valdete Daka: Faleminderit, at`here kush është që Nehat Gashi të emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Prizren nga subjekti politik Bashkimi Demokratik, duke e zëvendësuar antarin komunal Shani Berisha. Kush është për ? Faleminderit.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal në Prizren

Valdete Daka: E kemi edhe një pikë të rendit të ditës. Bajrami, ka një propozim...!

Bajram Ljatifi: Shpesh dëgjojmë në media që votuesit janë në një mënyrë në konfuzitet pasi që nuk është ndërruar ligji, prandaj thërras KQZ-në që, të mundësohet që votuesit të votojnë me të njejtat dokumente siç, kan votuar deri më tani.

Betim Gjoshi: E para, në vendimet e tjera nuk kemi shënuar diçka ma shumë ose ma pakë , përveq që kemi shtuar një çështje që edhe atyre që u ka skadu afati e janë në listë votuese të votojnë, dmth edhe

atyre që i ka parapa ligji. Kjo është mirë që po bëhet në këtë fazë për një punë që është mirë me u futë në plan programe të trajnimit, edhe unë nuk mendoj që është i vetmi që duhet të futet në plan programe të trajnimit, duhet të futen edhe çështjet me veprat penale në zgjedhje, keqpërdorimet e ndryshme që duhet me u përcjell si udhëzues për KVV-t , se na i kemi shkru 1 ditë ose 2 para zgjedhjeve jo rradhë here kanë mbri para kshillit të vendvotimit edhe kemi pas telashe , na më duket herën e fundit kemi marrë njoftim nga Ministria e Punëve të Brendshme që kujtoj 5-6 mijë vetë janë mirë me dokumente të skadume dmth të paktën kështu na kanë thanë në puntorinë e fundit, kështu që nuk është numri dita e ditës po shkon duke u zvogluar, mirë është me ja dhanë mundësin gjdokujt që është në listat e votusev edhe me pas mundësin me i indendifiku kshilli i vendvotimit që na me kanë si gjithëpërshirës. E dyta, ish kanë mirë që pas miratimit të këtij udhëzuesi i cilli unë mendoj që asnjë shkronjë nuk duhet të ndrrohet nga ai i vitit të kaluar përveq , i zgjedhjeve të vitit të kaluar përveq datës që ta përcjellim deri te këshillet e vendvotimit se ata do të janë ditën e fundit që do ta implementojnë...

Adnan Rustemi: Për mua, ka një keqkuptim në këtë situatë, sepse kjo çështja e dokumentit të identifikimit i ka dy aspekte për mu. E para, cilat janë dokumentet reale, që identifikohet votuesi në vendvotim. Çështja tjetër e dokumenteve të skaduara. Unë, pajtohem që dokumenteve që u ka skaduar afati, e që jua në dokumente zyrtare dhe i identifikojnë votuesit me u leju, për mos me i'a pamundësu votuesit munësinë dhe të drejten e votes. Por, parimin që duhet me pasë parasyshë gjithmonë, kur bëhet fjalë për identifikim të votuesve, është ai që dokumenti me të cilin identifikohet votuesi në ditën e zgjedhjeve, duhet t'i përmbajë të dhënat e njejta që i përmbanë lista përfundimtare e votuesve. Në të kundërtën nuk ka asnjë kuptim dokumenti i identifikimit. Nuk bëhet fjalë vetem me u identifikuar, vetem me emer e mbiemer. Bëhet fjalë me i identifiku në terësinë e të dhënave. Kështu që unë e kam thënë gjithmonë, dhe këtu po e përsëritet një gabim, nuk e di pse nuk po qartësohet, që në dokumentet e identifikimit, në ditën e zgjedhjeve, po i referohet komplet nenit që i përfshinë edhe kartelat e vlefshme, të personave të zhvendosur brenda vendit dhe kartela e vlefshme të refugjatit. Kjo për mu është anakronike. Kjo është e pakuptimitë, kështu në praktikë, sepse, nëse je refugjat ti nuk je këtu. Kjo vlenë për votuesit jashtë vendit. Ligji dhe ligjvënësi i ka renditë në të njejtin nen, për shkak të, i renditë dokumentet e identifikimit në tanësi të drejten e votes, por praktika l ndanë. Ata që janë me karta të refugjatëve, e me kartela të personave të zhvendosur, e përdorin për të votuar nga jashtë vëndit, sepse nuk munden me e votu brenda vendit, sepse nuk janë ketu. Nuk ka logjikë kjo. Nëse janë ketu, nuk janë refugjat. Nëse nuk janë refugjat, nuk kanë kartelë refugjati, kanë letërnjoftim. Këtu, unë mendoj që, kam kërkun edhe në doracak, duhet kartela e vlefshme e refugjatit dhe e personave të zhvendosur, duhet me u përdorë dhe me i udhëzu votuesit jashtë vendit. Bashkë me këto 4 dokumente tjera. Për me konkretizu, për votim jashtë vendit vlejné të gjitha këto, por për votim brenda vendit vlenë vetem pika a,b,c dhe d. që janë letërnjoftimi, patenti, pasaporta. Për me qartësuar...

Betim Gjoshi: Unë, pajtohem që e gjitha kjo që po thotë Adnani është logjike. Ne e kemi edhe në nen të ligjit, e kemi lëshuar edhe në këtë udhëzimin. Nuk kemi pasë ndonjë rast në teren ku, që na ka thënë dikush që janë duke e përdorur. Problemi është se, ai ka qnë qëllimi i ligjvënësit. Specifikat i ka paraparë

ligjvënësi. Ne, edhe mundemi me i hjekë këto dyja prej vendimi, por edhe nëse i lemë nuk prishë punë, sepse i ka lënë ligjvënësi në ligj, edhe pse nuk e ka qartësuar këtë...

Nenad Rikallo: Ekziston një dallim sa i përketë përkthimit në ligj në gjuhën shqipe, serbishte dhe anglishte, dhe kjo në zgjedhjet e kalueme ka sjellë në konfuzion edhe komisionet komunale dhe trajnerët. Ne, kemi marrë disa versione, dhe doracakët që kemi marrë në shqip dhe serbishtë kanë qenë të interpretuar ndryshe. Unë, e përkrahi atë që është në ligj, dhe ne ligjin nuk guxojmë ta ndryshojmë...ne, duhet implementuar...sot, mendoj që duhet të marrim vendim si në zgjedhjet e kaluar, dhe se të gjithë njerëzit që e vërtetojnë identitetin e tyre, që kanë dokumente të ligjshme kanë të drejtë të votojnë...

Valdete Daka: Edhe unë pajtohem me Adnanin me atë që tha se, është jologjike që kartela e refugjatit të përdoret këtu. Mirpo, meqenëse është, në ligj, ne me një vendim nuk mundemi me ndërru ligjin, edhe pse në praktikë nuk kemi pasë që dikush ka votuar. Bile, jo që është raportuar ajo, sepse nuk mundet refugjati me ardhë me votu këtu, por prap po e perseris, ne nuk mundemi me një vendim të KQZ-së me e ndryshu ligjin. Unë po e kuptoj Adnanin, dhe plotësisht pajtohem edhe unë, por derisa I kemi në fuqi, ne nuk mundemi me leshu tjetër udhëzim, fatkeqësisht, përveç me këtë që I kemi pasë edhe në zgjedhjet e kaluara. Shpresojmë që, ndoshta do të ndërrohet ligji. Nëse kurrgjë tjetër, nëse krejt reforma, bile disa çështje tjera të cilat na kanë penguar ne në punë. Pra, të bëhet amandamendimi. Po...?

Adnan Rrustemi: Unë vetem po du me bë të qartë qëndrimin tim, që e bazoj në ligjislacion. Çështja është kështu. Ne në fakt po nxjerrim udhëzim për me qartësu, në këtë rast komisioneret. Kurrëfar qartësimi nuk po bëjmë, nëse e shkëpusim komplet nenin dhe vendosim në një dokument të tillë. Ligji shpërndahet. Ata munden me i`u referu ligjit. Nëse nuk zberthet neni, nuk është udhëzim për mu. As nuk është sqarim. Por, mendoj që duhet me i`a përshtatë edhe ligjeve tjera. Ne kemi ligje për dokumente që deshmojnë shtetësinë dhe identitetin në Kosovë. Dhe, duhet të jemi në përputhje me ato. Për me sqaruar, sekretariate ka mundur me i`u drejtuar me një shkresë Ministrisë së Punëve të Brendshme. Me kerkuar, cilat janë dokumentet e vlefshme, që e deshmojnë identitetin zyrtarë në Kosovë. Si shtetas të Kosovës, për qytetarët e Kosovës, sepse ne nuk po flasim për njerëz tranzit, që kalojnë në Kosovë. Ata, kuptohet që nuk kemi pse! Por, megjithatë, ju miratone. Unë jam kundër.

Bajram Ljatifi: Të gjithë ne pajtohemi, por ligji që rregullon identifikimin e qytetarëve me ligjin e zgjedhjeve..., do të thotë në këtë rast, bëhet vetëm për zgjedhje..., dhe në këtë rast, ka përparësi ligji për zgjedhjet. Mirë është që në praktikë nuk kemi raste...ju falemnderit shumë...

Valdete Daka: Kush është që ta votojmë këtë udhëzim, ashtu siç e kemi pasur në vitin 2014...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan me shumicë votash këtë udhëzim.

Për KQZ

Valdete Daka

=====